



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.11, datë 05. 04. 2012

PËR

**“RISTRUKTURIMIN E QENDRËS SOCIALE “TË QËNDROJMË SË BASHKU”,
“QENDRËS KOMUNITARE MULTIDISCIPLINARE PËR FËMIJËT DHE FAMILJEN NË
NEVOJË” DHE “QENDRËS KOMUNITARE PËR TË MOSHUARIT”, MIRATIMIN E
STRUKTURAVE TË TYRE ORGANIZATIVE SI DHE RISHPËRNDARJET NË BUXHETIN
E BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2012”**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3/II, gërma “c”, nenit 32, gërma “ç”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar); ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, për “Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” (i ndryshuar); nenit 44 paragrafi i dytë, shkronja “c” të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 5, shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 12.08.1999, “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 1547, datë 27.8.2009, për “Nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 55, datë 16.09.2005, “Për kalimin kapital të asetit të Ndërmarrjes Riparim Materiale Poligrafike “Oficina” Bulevardi “Zogu i I-rë” Bashkisë Tiranë, si dhe ndryshimin e destinacionit të këtij objekti në “Qendër Sociale Komunitare për Fëmijët dhe Familjet në nevojë”; vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 20.12.2005 “Për kalimin kapital të asetit “Pjesë e objektit” të ndërmarrjes së shërbimeve mekanike, Rruga “Sabaudin Gabrani” Bashkisë së Tiranë si dhe ndryshimin e destinacionit të këtij objekti në qendër sociale “Të qëndrojmë së bashku”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.62, datë 10.11.2006 për “Krijimin e Qendrave Sociale “Qendër Komunitare Multidisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë”, Qendrës të “Qëndrojmë së Bashku” dhe Qendrës “Qendër Komunitare për të Moshuarit”, miratimin e strukturës organizative dhe financimin e kontributit të Bashkisë së Tiranës”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, date 29.10.2007 për "Krijimin dhe funksionimin e mencës në qendrën sociale "Të qëndrojmë së bashku" si dhe për miratimin e një ndryshimi në strukturë"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 25, datë 28.12.2011, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2012”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë bashkimin e Qendrës Komunitare Multidisiplinare për Fëmijët dhe Familjet në Nevojë me Qendrën Komunitare për të Moshuarit, me vendndodhje në Rrugën “Maliq Muça”,

Njësia Bashkiake nr. 9, në një qendër të vetme. Emri i kësaj qendre do të jetë **“Qendër Sociale Multidisiplinare”**. Të miratojë strukturën e ndryshuar të qendrës **“Të qëndrojmë së bashku”**.

- 1.1 Në zbatim të pikës 1, bilancet përmbledhëse të qendrave, të cilat do të bashkohen në një të vetme do të përcaktohen në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, (i ndryshuar).
2. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi do të fillojnë më datë 1 Maj 2012 dhe do të përballohen nga rishpërndarja e buxhetit të Qendrës Komunitare për të Moshuar dhe Qendrës Komunitare Multidisiplinare për Fëmijët dhe Familjet në Nevojë si më poshtë:
 - 2.1. Pakësohet buxheti i “Qendrës Komunitare për të Moshuar”, si më poshtë:

a.	Zëri 600 “Paga”	2 843 000 lekë
b.	Zëri 601 “Sigurime Shoqërore”	652 000 lekë
c.	Zëri 602 “Shpenzime Operative”	578 000 lekë
 - 2.2. Pakësohet buxheti i “Qendrës Komunitare Multidisiplinare për Femijet dhe Familjet në Nevojë”, si më poshtë:

d.	Zëri 600 “Paga”	4 264 000 lekë
e.	Zëri 601 “Sigurime Shoqërore”	450 000 lekë
f.	Zëri 602 “Shpenzime Operative”	650 000 lekë
 - 2.3. Krijohet buxheti i “Qendrës Sociale Multidisiplinare”, si më poshtë:

g.	Zëri 600 “Paga”	3 877 000 lekë
h.	Zëri 601 “Sigurime Shoqërore”	617 000 lekë
i.	Zëri 602 “Shpenzime Operative”	1 228 000 lekë
 - 2.4. Shtohet buxheti i “Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku””, si më poshtë:


j.	Zëri 600 “Paga”	2 120 000 lekë
k.	Zëri 601 “Sigurime Shoqërore”	345 000 lekë
l.	Zëri 602 “Shpenzime Operative”	1 250 000 lekë
3. Fondet e akorduara nga buxheti i vitit 2012 dhe të papërdorura nga “Qendra Komunitare për të Moshuar” dhe “Qendra Komunitare Multidisiplinare për Fëmijët dhe Familjet në Nevojë”, së bashku me detyrimet e pashlyera respektive, i kalojnë “Qendrës Sociale Multidisiplinare”, që krijohet nga bashkimi i tyre
4. Niveli i pagave për punonjësit në Qendrën Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, Qendrën Sociale Multidisiplinare dhe Qendrën Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, do të jetë sipas lidhjes së pagave nr.9, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të miratohen strukturat organizative të Qendrave sipas organogramave përkatëse, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

6. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në qendrat sociale ditore të përkujdesit shoqëror do të jetë jo më shumë se 150 lekë (njëqind e pesëdhjetë lekë).
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Qendra Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, Qendra Sociale Multidisiplinare, dhe Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.


K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI

ORGANOGRAMA E STAFIT TË QENDRËS SOCIALE MULTIDISIPLINARE



ORGANOGRAMA E STAFIT TË QENDRËS SOCIALE "TË QËNDROJMË SË BASHKU"



Lidhja Nr. 9**NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E QENDRAVE SOCIALE**

Nr.	Funksioni	Klasa	Paga bazë	Shtesa për vjetërsi
			1	2
1	Drejtor i Qendrës	XII	62 000	1%
2	Financier	VIII	40 000	1%
3	Punonjës social	VIII	40 000	1%
4	Psikolog	VIII	40 000	1%
5	Fizioterapist	VIII	40 000	1%
6	Terapist	VIII	40 000	1%
7	Jurist	VIII	40 000	1%
8	Mjek	VIII	40 000	1%
9	Edukator	VIII	40 000	1%
10	Operator Social	VIII	40 000	1%
11	Shofer, Mirëmbajëes	II	22 000	1%
12	Ndihmës kuzhine, Pastrues, Roje	I	20 000	1%

Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr. 9** të jepet në masën **1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën bazë**.